



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

3155
23.06.2016

Nr. 8015/3408/1207 Them.

Nr. 1320 Vendimi

Datë 10.10.2014 regjistrimi

Datë 25.05.2016

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga:

GJYQTAR : Kastriot SELITA

GJYQTARE : Altina NASUFI

GJYQTARE: Bernina KONDI

-asistuar nga sekretare gjyqësore Raimonda Aliaj, në Tiranë në datë 25.05.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me palë ndërgjyqëse:

PADITËS :

Shoqëria Kursim Kredi “Guri i Mirë”, me NUIS K 88429101V, me seli në Kuçovë, Lagja “Tafil Skëndo”.

Unioni Shqiptar Kursim Kredi me NUIS K 11931001t, me seli në Tiranë, Rruga “Qemal Stafa”, pallatet 9-katëshe, kati 2-të, nr. 70.

TË PADITUR :

Drejtoria e Apelimit Tatimor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me adresë: Rruga “Gjin Bue Shpata”, Tiranë.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, me adresë në Lagja
"30 Vjetori", Berat.

OBJEKTI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 23128/1 prot, datë 24.01.2013 i
Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë, Drejtoria e
Përgjithshme e Tatimeve Tiranë dhe aktit administrativ
"Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 3381 prot.,
datë 26.09.2012 i Drejtorisë Tatimore Berat.

BAZA LIGJORE

Ligji me nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore
në Republikën e Shqipërisë", neni 18 i ligjit nr. 7697, datë
07.04.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar,
Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008
"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i
ndryshuar, ligji nr. 8782 "Për shoqëritë e kursim kreditit",
neni 324 e vijues i Kodit të Procedurës Civile, Udhëzim i
Ministrit të Financës nr. 26, datë 16.04.2009 "Për
mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve
shoqërore dhe shëndetësore".

Gjykata e Rrethit Gjyqsor Berat me vendimin nr. 402, datë 08.04.2013 ka vendosur:

- Pushimin e gjykit të çështjes civile me nr. 569, datë rregjistrimi datë 28.02.2013 me
palë pjesmarrëse në gjykim: paditës: Shoqëria Kursim Kredi Guri i Mirë, me seli në
lagjen "Tafil Skëndo" Kuçovë dhe Unionit Shqiptar Kursim Kredi, Tiranë të përfaqësuar
nga Elvana Cule (me autorizim), dhe i paditur : Drejtoria e Apelit Tatimor, Tiranë dhe
Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Berat përfaqësuar nga juristja Silvana Sallo me "Prokurë
përfaqësimi", me objekt: Shfuqizim vendimi nr. 23128/1 prot, datë 24.01.2013 dhe Aktit
Administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimin Tatimor, nr. 3381 prot., datë 26.09.2012 i
Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë dhe i Drejtorisë Tatimore Rajonale, Berat.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse siç janë bërë.

Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim për në Gjykatën e Apelit Vlorë palët paditëse duke kërkuar prishjen e vendimit të pushimit të gjykimit.

Gjykata e Apelit Vlorë, e vendimin nr. 182, datë 26.06.2014 ka vendosur:

- Shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje civile dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Altina Nasufi, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes:

1. Paditësi Shoqëria e kursim kredisë “Guri i Mirë” ushtron aktivitet në marrjen e depozitave me/pa interes vetëm nga anëtarët, të sigurojë mundësinë e kthimit korrekt të kredive, t’ua jap hua vetëm anëtarëve të shoqërisë, të përcaktojë afatet dhe kushtet, të inkurajojë ndihmën reciproke.

Nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, është ushtruar kontroll në shoqërinë e kursim kredisë “Guri i Mirë”, në bazë të urdhërit të punës nr. 1536/1 ku është mbajtur akt konstatimi me nr. serie 0289653, i datës 04.07.2012 pasi u konstatua se sipas shkresës me nr. 1462 prot , datë 25.06.2012 nga sektori i vlerësimit për subjektet nga kontrolli “është gjetur në këtë subjekt të hapur (në aktivitet) një (vajzë) shtetase Ruzhdie Bega me profesion llogaritare e datëlindjes 25.11.1958, kontrolli u përfundua në orën 10:30”.

1.1 Nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, bazuar në procesverbalin sipërpërmendur, është nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 3381 prot, datë 26.09.2012 ku është ngarkuar në total me detyrimin 50.000 lekë për arsyen e shkeljes së nenit 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar “Mosdeklarim i të punësuarve”.

1.2 Nga Unioni Shqiptar Kursim Kredi (zyrat qendrore) ka rezultuar se shtetasja Ruzhdie Bega është punonjëse e saj (sipas deklaratës së punëmarrësve tremujori i dytë 2012 ku kjo shtetase rezulton *pa pagesë*) e cila ka një kontratë pune të datës 01.01.2012 me kohëzgjatje deri në 31.03.2013, (e cila sipas përshkrimit të punës do të jetë llogaritare pranë shoqërisë Kursim Kredie Guri i Mirë) dhe ka rezultuar se ISSH nëpërmjet "Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2012 për shtetasen Ruzhdie Bega, rezulton i derdhur kontribut deri në gusht, kurse nga Drejtoria Rajonale Tiranë me shkresën e datës 18.10.2012 e nr. 952 prot është lëshuar vërtetim se personi juridik/fizik "Unioni Shqiptar Kursim Kredi" në mbështetje të deklarimeve të pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore hëndetësore në emrin znj. Ruzhdie Bega janë deklaruar të paguara kontributet muaji qershor-torator 2012".

1.3 Kundër aktit të mësipërm, paditësat pra shoqëria Kursim Kredi "Guri i Mirë" dhe Unioni Shqiptar Kursim Kredi kanë bërë ankimin administrativ në Drejtorinë e Apelit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, (sipas dëftesës për pranimin e objekteve postare është bërë ankimi më datë 29.10.2012) e cila me Vendimin nr. 23128/1 prot, datë 24.01.2013 "Kërkesë për Apelim", ka vendosur: *Lënien në fuqi të aktit objekt ankimi njoftim vlerësimit për tatimet tatimore nr. 3381 prot, datë 26.09.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat dhe pezimin e ankimit. Kundër këtij vendimi, në zbatim të nenit 109 të ligjit Nr. 9920, datë 14.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH-së", lejohet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve kalendrike nga data e marrjes dijeni."*

Duke mos qënë dakord me aktet e mësipërme, pasi kanë ezauruar rrugën e ankimit administrativ, palët paditëse i janë drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

Vlerësimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat:

Gjykata ka pushuar gjykimin me këtë arsye:

Seanca gjyqësore e caktuar për zhvillim për në datën 08.04.2013 ora 09.00, nuk u zhvillua mosparaqitje të përfaqësuesve të palëve paditëse, paditës dhe i paditur, të përfaqësuar ekskluzivisht për palën paditëse nga Elvana Cule (me autorizim) të datës 21.02.2013 dhe për

palën e paditur përfaqësuesja juristja Silvana Sallo , me prokurë përfaqësimi datë 19.03.2013 e nr.839 prot.

3.2 Hetohen shkaqet e mosparaqitjes për përfaqësueset e palëve pjesëmarrëse në gjykim (paditës dhe i paditur) dhe rezultoi se dijenia i konfirmohet rregullisht nga seanca e mëparshme për datën 21.03.2013, pasi kanë qenë prezent. Përfaqësueset e palëve pjesëmarrëse në gjykim, për palën paditëse përfaqësuesja me autorizim Elvana Cule dhe për palën e paditur, përfaqësuesja me "Prokurë përfaqësimi" Silvana Sallo (juriste).

3.3 Nga seanca përgatitore e datës 21.03.2013 ku dhe kanë qenë prezent, ka marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 08.04.2013 ora 09.00, ku dhe kanë nënshkruar rregullisht emër, mbiemër, firmë (lexo proces verbalin e seancës përgatitore, datë 21.03.2013). Përfaqësueset e palëve pjesëmarrëse në gjykim (paditës + e paditur), për të justifikuar mosprezencën nuk paraqitën asnjë shkak ligjor, që t'i jepnin mundësi gjykatës të ndërpriste shqyrtimin gjyqësor dhe ta shtynte seancën gjyqësore për në një datë tjetër.

3.4 Dispozita e nenit 179/1 e K.Pr.Civile shprehet :*"Nëse paditësi ose asnjë nga palët , pa shkak të arsyeshëm nuk paraqiten si në veprimet përgatitore ashtu dhe në seancën, dhe rezultoi se kanë dijeni rregullisht ,gjykata apo gjyqtari i vetem vendos pushimin e gjykimit."* Lidhur me këtë dispozitë dhe neni 2/1 i K.Pr.Civile shprehet:*"Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe"*. Në interpretim të këtyre dy dispozitave ligjore të mësipërme kuptohet që në asnjë rast dhe asnjëherë procesi gjyqësor nuk zhvillohet pa praninë e palës paditëse.

3.5 Në interpretim të dispozitave të sipërcituara, kur seanca gjyqësore e datës 08.04.2013 ka qenë e caktuar për zhvillim në orën 09.00, gjykata priti prezencën e palëve pjesëmarrëse në gjykim (paditës dhe i paditur) deri në orën 09.30, dhe më pas disponoi konform dispozitave të ligjit procedural civil të sipërcituara.

III.Shkaqet e ngritura në ankimin e palës paditëse:

4. Vendimi i gjykatës është i jashtëligjshëm dhe në shkelje të rregullave procedurale të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor për arsyet e mëposhtme:

4.1 Në datën 21 Mars 2013, u zhvillua seanca përgatitore lidhur me këtë çështje gjyqësore civile, me pjesëmarrjen e të dyja palëve (paditësit dhe të paditurit). Në përfundim të kësaj seance, gjykata vendosi që seanca e ardhshme të zhvillohej në datën 11 prill 2013, ora 11:00. Ndryshe nga praktika gjyqësore që është hasur në gjykata të tjera në të cilat palët prezent në proces i shkruajnë marrjen dijeni lidhur me datën dhe orën e seancës së radhës, në rastin konkret gjykata i kërkoi marrjen dijeni të palëve prezent në proces. Në datën 11 prill 2013, ora 11:00, palët paditëse janë paraqitur në gjykatë së bashku me palën e paditur disa minuta para orës së fillimit të seancës gjyqësore. Gjyqtari ishte i zënë dhe megjithëse u kërkua të kontaktohej me të, ai nuk pranoi të fliste me arsyen se ishte në gjyq. Pak me vonë pala e paditur u vu në dijeni se gjykimi ishte pushuar me arsyen se seanca ishte në orën 09:00 dhe jo në orën 11:00. Palët bëri përpjekje përsëri të kontaktojnë me gjyqtarin, por ai bërtiti të mbyllej dera dhe të bëhet ankim lidhur me vendimin e pushimit.

4.2 Në këtë mënyrë në mënyrë krejtësisht arbitrare gjykata i ka hequr palës paditëse shoqërisë Guri i Mirë të drejtën për proces të rregullt gjyqësor nëpërmjet të cilit të mund të dëgjohet dhe të ushtrojë të drejtën e ankimit kundër aktit administrativ të nxjerrë nga organet e administratës tatimore. Shoqëria Kursim-Kredi "Guri i Mirë", ka ankimuar njoftim vlerësimin e Drejtorisë Rajonale Berat nr. 81 prot, datë 26.09.2012, brenda afateve ligjore në Drejtorinë e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duke kërkuar: "Shfuqizimin e njoftimit vlerësimit për detyrimet tatimore nr. 3381 prot, datë 26.09.2012". Drejtoria e Apelit Tatimor ka marrë në shqyrtim këtë ankim dhe me vendimin e saj Nr. 23128/1 prot, datë 24 janar 2013, ka vendosur: Lënien në fuqi të aktit objekt ankimi njoftim vlerësimit për Detyrimet Tatimore "Ndryshimin e aktit administrativ, objekt ankimi, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 3381 prot, datë 26.09.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat dhe rrëzimin e ankimit". Palët paditëse duke gjykuar që gjoba e vendosur sipas këtij njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nuk qëndron dhe ky akt administrativ mund të ankimohet, në kuptim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Për Këputjen e Procedurave Administrative", në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në bazë të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në

Republikën e Shqipërisë”, shoqëria në cilësinë e palës paditëse ka regjistruar kërkesë padinë e saj, përsëri brenda afateve të përcaktuara ligjore.

4.3 Në seancën e dytë të zhvillimit të këtij gjykimi në mënyrë krejtësisht të pakuptueshme, në shkelje të procedurës gjyqësore dhe duke mohuar një proces të rregullt ligjor gjykata e Beratit vendos pushimin e gjykimit.

IV. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

5. Gjykata kryesisht konstatoi se çështja përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo ka kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykimit të saj bazuar në nenet 7 dhe 10 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar dhe duke iu referuar për zbatim Vendimit Njehsues Administrativ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3, datë 06.12.2013.

6. Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, Gjykata e Apelit konstaton se ankimi i veçantë është paraqitur brenda afatit ligjor, në formën e duhur procedurale, para gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar aktivisht në padi, legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit sipas përcaktimeve të nenit 452 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

7. Vendimi nr. 402, datë 08.04.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat objekt ankimi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt gjyqësor të zhvilluar në shkelje të rënda të rregullave procedurale dhe për këtë shkak duhet prishur dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim.

8. Referuar 179 të Kodit të Procedurës Civile kur paditësi pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk paraqitet si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore, ndonëse ka dijeni rregullisht, atëherë Gjykata vendos pushimin e gjykimit. Gjithashtu konform nenit 299, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur ai parashikohet shprehimisht në ligj. Një rast i tillë është ai i parashikuar nga neni 179 i Kodit të Procedurës Civile.

9. Referuar akteve të njoftimit të ndodhura në dosjen gjyqësore, rezulton që pala paditëse së bashku me palën e paditur kanë marrë dijeni për seancën përgatitore që do të zhvillohej në gjykatën e shkallës së parë në datë 21.03.2013. Përfaqësuesit e të gjitha palëve në proces kanë marrë pjesë në këtë seancë përgatitore duke dhënë shpjegimet e nevojshme në funksion të sqarimit të natyrës së mosmarrëveshjes në gjykimin dhe përcaktimit të rrethit të provave që do t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor. Në përfundim të gjykimit palët kanë rënë dakort për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore që do të zhvillohej më datë 08.04.2013 ora 09:00, sipas përmbajtjes së procesverbalit. Ky procesverbal nuk është nënshkruar nga asnjë prej përfaqësuesve të palëve të pranishme në lidhje me marrjen dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore.

10. Në ankimin e paraqitur nga pala paditëse është pretenduar se gjykata ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore për datën 11.04.2013, ora 11:00. Pala paditëse ka pretenduar se në datën 11.04.2013, ora 11:00, janë paraqitur në gjykatë së bashku me palën e paditur disa minuta para orës së fillimit të seancës gjyqësore. Gjyqtari ishte i zënë dhe megjithëse u kërkua të kontaktohej me të, ai nuk pranoi të fliste me arsyen se ishte në gjyq. Pak me vonë pala e paditur u vu në dijeni se gjykimin ishte pushuar me arsyen se seanca ishte në orën 09:00 dhe jo në orën 11:00...”

11. Në kuptim të përcaktimeve ligjore të nenit 158/a i Kodit të Procedurës Civile por edhe të nenit 25 të ligjit nr. 49/2012, zhvillimi dhe dokumentimi i veprimeve përgatitore është njëra hallkë e procesit gjykimor që ndihmon palët dhe gjykatën për të përcaktuar natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim, për t'u njohur me shpjegimet e nevojshme të palëve, etj, fazë në të cilën mund të kryhen disa prej veprimeve procedurale të listuara në nenin 158/a.¹ Ndërsa neni 179 i Kodit të Procedurës Civile që rregullon pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve në proces, është dispozitë që bën pjesë në Kreun e II të këtij Kodi me titull “*Drejtimi i Procesit dhe seanca gjyqësore*”. Debati gjyqësor mes palëve ndërgjyqëse sipas parimit procedural civil të kontradiktoritetit, respektimi i parimit të barazisë së armëve dhe palëve, karakteri publik i gjykimit, zhvillimi gojor i procesit duke iu dhënë palëve e drejta e mbrojtjes, shqyrtimi gjyqësor i provave, etj, bëhen vetëm në seancë gjyqësore. Në seancën gjyqësore të datës 08.04.2013 sipas konstatimit të gjykatës nuk është paraqitur asnjë prej palëve ndërgjyqëse, as përfaqësuesja e

¹ Plotësimi i të metave të padisë; përjashtimi i paditësit nga taksa mbi aktet; përcaktimi i dëshmitarëve që do të thirren në gjykim; etj.

palëve të paditura e cila rezulton të ketë qënë e pranishme në seancën e veprimeve përgatitore. Në kuadër të së drejtës për akses dhe ankim efektiv në gjykatë, si element esencial i së drejtës për proces të rregullt ligjor garantuar nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Administrative e Apelit konkludon se gjykata e rrethit gjyqësor Berat nuk ka kryer një proces të rregullt gjyqësor duke mos i garantuar palëve ndërgjyqëse dijeninë efektive për gjykim nëpërmjet njoftimit të rregullt dhe të dokumentuar sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për seancën gjyqësore. Në këto kushte, sipas shkronjës “ç” të nenit 50 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në rastin për shkeljet proceduriale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjyimit. Kurse në nenin 54 gërma “ç” të ligjit Nr. 49/2012 është parashikuar se Gjykata Administrative e Apelit prish vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe ia dërgon çështjen organit kompetent për rigjykim kur gjykata ka shkelur dispozitat lidhur me njoftimin e palëve dhe kur një shkelje e tillë ka ndikuar në dhënien e vendimit.

12. Duke u bazur në sa me sipër dhe duke iu referuar për zbatim Vendimit Unifikues Administrativ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 06.12.2013, Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar përfundimisht vlerëson se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat duhet prishur dhe çështja duhet dërguar për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore e tokësore për gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje administrative me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, në datë 04.11.2013.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 50, shkronja “ç” dhe 54, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar


VENDOSI:

- Prishjen e vendimit nr. 402, datë 08.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më 25.05.2016


GJYQTARE

Bernina KONDI



GJYQTARE

Altina NASUEI



GJYQTAR

Kastriot SELITA

